«Kanë punuar pa u lodhur për realizimin e tejkalimin e planit të shtetit, kanë realizuar normën ditore dhe kanë punuar me metoda përparimtare për ngritjen e rendimentit dhe përmirësimin e kualitetit të punës»

17. NË N. L. N. DURRËS

ME URDHËRIN E PUNËS TË KL. III-të

1) Shaqir Ahmet Çelçima
2) Isuf Adem Muja
3) Selman Adem Ademi
4) Rahman Ali Bardhi
5) Islam Shefik Sula
6) Rako Aleks Qosja
7) Athanas Dimo Sherko
8) Kapllan Rifat Toçi
9) Ramiz Daut Lala
10) Lluka Kristaq Teodori
11) Nikolla Petro Merga
12) Kristaq Teodor Dumi

me këtë motivacion:

«Punëtorë të dalluar dhe të ndërgjegjshëm në punë, kanë punuar pa u lodhur për realizimin e planit të shtetit, duke realizuar normën ditore të punës në një përqinaje të konsideruarshme, në këtë mënyrë janë bërë shembull në punë edhe për punonjësit e tjerë».

1
3) Petraq Vangjel Çerepi
4) Ylli Kostandin Dokia
15) Vlash Perikli Goga
16) Bajram Rifat Toçi
17) Dimo Taqi Sherko
18) Sefer Sefer Domi

me këtë motivacion:

«Kanë organizuar dhe drejtuar mirë punën e sektorëve të tyre. Janë treguar të palodhur në kryerjen e detyravet që u janë ngarkuar dhe kanë qënë të gatëshëm për realzimin e planit të shtetit.

ME MEDALJEN E PUNËS

1) Halil Ramazan Emini
2) Avdulla Qazim Kaçuli
3) Ëtem Xhafer Veseli
4) Naun Jorgji Bici
5) Avdul Avhulia Sina
6) Petro Mihal Kushi
7) Farmir Ramazan Kreka
8) Mehdi Muho Dedej
9) Dhori Mihal Stefo
10) Iljaz Tahir Gruda

me këtë motivacion:

«Janë treguar të palodhur për realizlmin dhe tejkalimin e planit të shtetit. Kanë realizuar normat ditore dhe kanë punuar me metodat përparimtare për ngritjen e rendimentit dhe për përmirësimrn e kualitetit të punës».

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

11) Gezim Xhelal Keçi 12) Maria Prend Milloshi
me këtë motivacion:

«Janë mobilizuar me të gjitha forcat e tyre në punë, kanë kryer mirë detyrat që u janë ngarkuar dhe kanë ndihmuar pa u lodhur për mbarëvajtjen e sektorit ku punojnë».

Tiranë, me 30-4 1956
Nr. i dekretit: 2261

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sami Baholli

KRYETARI:
Haxhi Lleshi

URDHËRESË E QEVERISË

Nr. 9 Dt. 16 VI-1956

Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjen e datës 16-VI-1956. nxjerr këtë

URDHËRESË

MBI

DISA NDRYSHIME N'URDHËRESËN E QEVERISË

NR. 13 DATË 6-X-1955 MBI SHPËRBLIMET
E UDHËTIMIT TË PUNONJËSVE

Neni 1.

Në nenin 17 të urdhëresës Nr. 13 dt. 6-X-1953 «mbi shpërblimet e udhëtimit të punonjësve» behen ndryshime dhe shtesat që vijojnë:

Germa «a» e nenit të sipërmë ndryshohet në këtë mënyrë;

a) Të Gjitha qendrat e komiteteve ekzekutive të k. p. të qareve dhe qytetit Tiranës të caktuara me dekretin Nr. 2192 datë 26-12-1955 «mbi ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë».

Gërma «b» ndryshohet në këtë mënyrë:

«b) qendrat e tjera që vijojnë: Këlcyra, Delvina, Qyteti Memaliaj Leskoviku, Vithkuqi, Kavaja, Shijaku, Roskoveci, Shupenza, Kote, Konispol Ura vajgurore, Qyteti «Stalin», Libohova, Miloti Myzeqeja, Mamurasi, Zerqani, Rogozhina dhe Llixha e Elbasanit».

Pas gërmës «c» shtohet gërma «ç» në këtë përmbajtje:

«ç) qendrat e tjera që caktohen nga Ministria e Financave në marëveshtje me këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Neni 2.

Kjo urdhëresë hyn në fuqi me botimin e saië në gazetën zyrtare.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.
GOGO NUSHI

SEKRETAR' I PËRGJITHSHEM I
KËSHILLIT TË MIMISTRAVE
Spiro Rusha

KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr, 224 Datë 16-VI-1956

MBI

LEJET PLOTËSUESE PUSHIMI

Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, mbi propozimin e Këshillit Qëndror të Bashkimeve Profesionale, në bazë të nenit 80 të Kodit të Punës në mbledhjen e datës 16-VI-1956,

V E N D O S I :

1. Punëtorët dhe nëpunësit që kryejnë punë të dëmëshme për shëndetin dhe ata që punojnë në profesione që caktohen në listën e bashkëngjitur këtij vendimi, përveç lejes së zakonëshme vjetore, përfitojnë dhe një leje plotësuese në masën që caktohet për bri sejcilit.

2. Leja plotësuese mund të pakësohet ose edhe të hiqet fare nga ministria ose institucioni qëndror përkatës në marrëveshje me Këshillin Qëndror të Bashkimeve Profesionale, kur pakësohet ose zhduket karakteri i dëmëshëm ose i rëndë i punës për të cilën është caktuar kjo leje plotësuese.

3, Urdhëresa Nr. 43 datë 4 9-1950, mbi lejet e zakonëshme dhe suplementare, pjesa e vendimit Nr. 116 datë 8-4-1955, që cakton lejet e anëtarëve dhe kandidatëve të Istitutit të Shkencave, germa "ç" e pikës 2 të vendimit Nr. 240 datë 3-9-1954 mbi zhvillimin e industrisë dhe qymyr-gurit, si. dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, mbeten pa fuqi.

4. Këshilli Qëndror i Bashkimeve Profesionale të japë udhëzime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT TË MINISTRAVE R.P.SH.
GOGO NUSHI

SEKRETARI'I PËRGJITHËSHËM I
KËSHILLIT TË MINISTRAVE.
SPIRO RUSHA

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

LISTA E PUNËVE TË DËMËSHME PËR SHËNDETIN DHE TË PROFESIONEVE QË PËRFITOJNË NGA LEJA PLOTËSUESE

Nr. Ren	Përshkrimi i punës ose i profesionit,	Masa e lejes plotësuese në ditë pune.
1	Mjekët, përsonelí i mesën dhe i ulët mjeksor pastruesit e sallave, larësit e enëve dhe të teshave që punojnë në pavjone për sëmundje ngjitëse, dispanceri anti T.B.C.	10
2	Mjekët. përsonelí i mesëm dhe i ulët mjeksor dhe intruktorët që punojnë në pavjonet ose institutet psikonevrollogjike dhe psiqiatrike.	10
3	Mjekët që punojnë në kabinetet e rotgenit dhe në rotgenterapi	18
4	Përsonelí i mesën dhe i ulët mjeksor që punon në kabinetet e rotgenit dhe në rotgen-terapi.	12
5	Mjekët, kirurgët që punojnë në institutet kurative dhe gjinekollogët-obstetrik.	10
6	Laborantët që punojnë në objekte infektive	8
7	Mjekët, përsonelí i mesëm dhe ti ulët mjeksor si dhe gjithë punonjësit që punojn në leprozarët	24
8	Bakteriollogët, epidemiollogët dhe ndihmësit e tyre.	10
9	Dizinfektorët.	10
10	Intruktorët dizinfektorët.	8
11	Funksionarët e lartë të shtetit në rang Ministri e lartë, si dhe udhëheqësit e organizatave shoqërore qëndrore.	12
12	Zevëndës ministrat dhe punonjët e tjerë të këtij rangu në institucionet shtetërore, në organizatat shoqërore dhe kooperativiste, si dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të k.p.të qarqeve dhe të qytetit të Tiranës.	8
13	Drejtorat qëndrore dhe punonjësit e tjerë të këtij rangu në institucionet shtetnore, në organizatat shoqërore dhe kooperativiste, kryetarët e komiteteve ekzekutive të k. p. të rretheve dhe zëvëndës kryetarët e komiteteve ekzekutive të k. p. të qarqeve dhe qytetit të Tiranës, kryetarët e gjykatave dhe prokurorët e qarqeve. si dhe drejtorët dhe kryeingjinjerët e ndërmarrjeve ekonomike, kur kanë pagë mujore bazë 8,000, lekë e lartë.	6
14	Antarët e Institutit të Shkencave	12
15	Kanditatët e Institutit të Shkencave	10

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Nr. Ren	Përshkrimi i punës ose i profesionit:	Masa e lejes plotësuese në ditë pune
16	Arsimtarët profesionistë efektive që japin mesim rregullisht në shkolla e kurse	36
17	Drejtorët, N/drejtorët e shkollave 7/vjeçare	24
18	Drejtorët, N/drejtorët e shkollave të larta, të mesme, shkollave profesionale dhe shkollave me korespondencë	12
19	Drejtorat, N/drejtorat, mësuesit dhe instruktorët e shkollave të rezervave të punës,	12
20	Drejtorat, N/drejtorat, kujdestarët (edukatorët) instruktorët, shefat e seksioneve të shtëpive të fëmijës, të shtëpive pionierit dhe të parkut pionierit.	12
21	Drejtorët e kabineteve metodike. udhëheqësit profesionistë të rinisë dhe të pionervet	12
22	Drejtorët dhe edukatorët e kopshteve të fëmijëvet.	12
23	Regjizorët, solistët, artistët lirikë, koristët, orkestrantet, artistë e baletit, dirigjentet e ndihmës dirigjentet, balet maestri, pedagogët e zërit dhe të baletit, sufleri që merren kryesisht me këtë punë	18
24	Për punonjësit e theatrit, theatrit të kukllave në qendër e qarqet kryeregjizorët, regjizorët, aktorët sufleri që merren kryesisht me këte punë.	12
25	Për punonjësit e estradave në qendër e qarqet: regjizori, aktorët, valltarët, këngëtorët popullorë, orkenstrantet, konferencierë, prestigjatorët, akrobatët, sufleri që merren kryesisht me këtë punë.	10
26	Minatorët, armatorët ndimësit e tyre që punojnë në minierat (qymyr-guri.	12
27	Punëtorët që merren me transportimin e mineraleve në nëntokë (qymyr-guri)	12
28	Personeli inginjero teknik që kryejnë punë të ndryshme në nëntokë (qymyr-guri)	12
29	Minatorët e nëntokës në qëndra të tjera minerale të qymyr gurit,	10
30	Ndihmës minatorët dhe armatorët e galerive	8
31	Punëtorët që merren me transportimin e mineraleve në nëntokë.	8
32	Punëtorët, nënpunësit që kryejnë punë të ndryshme në nëntokë.	8
33	Punëtorët që merren me shkrirjen e serës	6
34	Punëtorët që merren me pastrimin e rezervave të naftës,.	6
35	Punëtorët e brigadave të pastrimit të puseve të naftës.	8

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Nr. Ren	Përshkrimi i punës ose i profesionit:	Masa e lejes pagesuese në ditë pune
36	Distiluesit dhe rafinerusit e alkoolit dhe të naftës	6
37	Punëtorët që punojnë në furrat e aglomeratit.	10
38	Ngurkuesit e furrave të bakrit.	10
39	Kroxhalistet dhe axhelistët.	10
40	Fonditorët dhe ndihmësit e tyre.	6
41	Punëtorët që merren me punimin e plumbit.	6
42	Saldatorët që punojnë me hidrogjen dhe oksigjen	6
43	Teknikët dhe punëtorët e dhomave të fermentimit të duhanit.	10
44	Punëtorët e repartit të harmanit.	6
45	Punëtorët e pregatitjes së duhanit në tenga, grirësit e duhanit dhe pastruesit e makinave të cingareve.	6
46	Krahësit e pambukut në uzinat e pambukut.	6
47	Punëtorët e repartit gëlqeres dhe skarnimit në fabrikat e lëkurave.	6
48	Punëtorët e ngjyrosjes në fabrikat e lëkurave.	6
49	Punëtorët e prodhimit të gëlqeres në furrat e përhershme.	6
50	Punëtorët që mbushin thasët në fabrikat e çimentos	6
51	Punëtorët e repartit të kalandrave dhe të pluhurosjes në fabriken e gomës.	6
52	Punëtorët e fabrikës qelqit që punojnë në repartin ku fryhet qelqi dhe kur shkrihet në furra.	10
53	Radhuesit në furra, pjekësit dhe nxjerrësit e tullave dhe të tjegullave në furrat me veprim të pa ndërprerë në fabrikat e tullave, furrat e poçerive dhe tubat grez.	6
53	Fokistët e kaldajave që punojnë me qymyr-guri dhe pastruesit e hirit.	6
55	Drejtori dhe punëtorët e tjerë të laboratorit bakteriollogjik në kombinatin e tekstilit "Stalin".	6
56	Punëtorët e pregatitjes së bojrave dhe solucioneve në fabrikat e ngjyrosjes dhe të tekstilit të leshit	6
57	Punëtorët që punojnë jo më pak se 4 orë në ditë në prodhimin ose përdorimin e acideve.	6
58	Punëtorët që punojnë në vënde që shkaktohet gaz karbonik dhe karbonat sod.	6
59	Maqinistet, ndihmësit e tyre, fokistet në anije dhe trena.	6
60	Mekanikët e kazanave që punojnë me qymyr-guri	6
61	Pullumbarët (zhytësit në ujë).	10
62	Punëtorët e rradhimit, linotipave, monotipave, stereotipave, derdhësit e germave si dhe shefat e teknikët e këtyre reparteve që drejtojnë prodhimin	10
63	Punëtorët e cinkografisë.	10

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Nr. Ren	Përshkrimi i punës ose i profesionit	Masa e lejes plotësuese në ditë punë
64	Punëtorët e litofsejt, makinistat, kartografisë dhe shtypësit e notave në shtypshkronja.	6
65	Pastruesit dhe meremetuesit e rjetit të kanalizimeve dhe të gropave të zeza.	10
66	Punëtorët dhe nëpunësit e thesarit dhe arkivit të shtetit.	6

APROVOHET:

ZËV. KRYETAR' I KËSHILLIT MINISTRAVE TË R.P.SH.

GOGO NUSHI

UDHËZIM I MINISTRIT NDËRTIMIT DHE I MINISTRIT FINANCAVE MBI APLIKIMIN E URDHËRESËS Nr. 2 DT. 20-1-1956 MBI STRUKTURËN E KOSTOS TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE MONTIMIT

Art. 1

Struktura e kostos të punimeve të ndërtimit dhe të montimit përbëhet nga dy grupe shpenzimesh :

I) Shpenzime direkte
II) Shpenzime plotsuese

Art. 2

1) Shpenzime direkte

Shpenzime direkte janë ato shpenzime që mund të përcaktohen direkt për një objekt të veçantë në ndërtim e sipër, që ka preventiv indipendent.

Bejnë pjesë të shpenzimeve direkte :

a) Kosto e materialeve
b) Meditjet kryesore,
c) Shpenzimet për shfrytëzimin e maqineris ndertimit.
d) Kosto e transportit dhe shërbimeve.

Art. 3

Kostua e materialeve llogaritet në preventiv në bazë të dispozitave teknike dhe të çmimeve që do të përcaktohen si çmime bazë për prevëntimin, duke u mbështetur në projektet e aprovuar, Kjo llogaritje përmban këta element kryesorë. a) çmimi i blerjes të materialeve, shpenzimet e ngarkim shkarkimit dhe shpenzimet e transportit të materialeve nga porti ose stacionin deri në magazinën e objektit të ndërtimit për materialet që shiten franko port ose stacion, b) çmimi i blerjes të materialeve dhe shpenzimet e shkarkimit në magazinat e objektit të ndërtimit për materialet që dërgo-

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

hen nga shitësi me automjet deri në magazinën e objektit, c) çmimi i blerjes të materialeve shpenzimet e ngarkim shkarkimit dhe të transportimit të tyre nga fabrika ose kumija për materialet që shiten franko fabrike ose franko kumi dhe ç) kosto e preventivuar në vendin e prodhimit, shpenzimet e ngarkim shkarkimit dhe të transportimit të materialeve nga vendi i prodhimit deri në magazinën e objektit të ndërtimit për materialet që prodhohen nga vetë ndërmarrjet e ndërtimit.

Mbi çmimin e kostos, franko magazinë e objektit, llogaritet një shtesë prej 3,5% për të përbolluar shpenzimet e aparatit të furnizimit dhe të depozitimit (magazinave) dhe firot legale të këtyre materialeve.

Art. 4

Meditjet kryesore të puntorisë llogariten në prevëntiv duke u mbështetur në normat dhe dispozitat ligjore mbi kategorimin dhe shpërblimin punonjësve që do të caktohen si çmime bazë për preventivimin.

Kontribut për sigurimet shoqërore, pagimi i ndërprerieve në punë që nuk mvaren nga puntorët (ndërprerje për kondita atmosferike ditë shiu etj.) lejet e zakonëshme dhe ditët e festave që u paguhen punonjësve simbas dispozitave ligjore në fuqi, mos daliet dhe ndërprerjet në punë në lidhje me zbatimin e detyrave shtetërore e shoqërore dhe shtesët që u peguhen brigadierëve që drejtojnë brigaden në punë, nuk bejnë pjesë të meditjeve kryesore këto caktohen në kuotat e caktuara për shpenzime plotësuese.

Në konsuntiv n'elementin meditje kryesore kontabilizohen:

a) meditjet bazë për punën e kryer efektivisht ose për kohën e punuar.

b) Shtesat eventuale për pagimin e normave progresive.

c) Shtesat për punë në turnin e natës kur punohet me tre turne dhe shtesat për vështirësi teknike në punë të parashikuara në normat e punës.

d) Pagesat që bëhen për ndërprerjet e punës për mungesë materialesh, energjije elektrike etj.

Për sa i përket shtesave në pagesat e puntorisë për punë me turne si dhe shtesat në pagesat e puntorisë për vështirësi teknike në punë të parashikuara në normat e punës që i paguhen puntorëve, tëcilat nuk mund të parashikohen në preventiv, me autorizim të punëdhënësit përfshihen në situacione duke u arketuar nga 5% të pa paraparë në preventivat.

Art. 5

Në Shpenzimet për shfrytëzimin e maqinave të ndërtimit përfshihen:

a) Ngarkimi, shkarkimi dhe transportimi i mekanizmave të ndërtimit në dhe prej kantierit: montimi, smontimi dhe prova e venijes së maqinerive në funksionim.

b) Energji, lendë djegëse, lubririkante dhe materiale të tjera ndihmëse dhe për pastrimin.

c) Rroga bazë e personelit sherbyes.

c) Amortizimi.

d) Meremetimet e vogla të maqinerisë dhe të agregateve (mirëmbajtje)

dh) mbajtje e parkut të maqinave per shfrytëzimi, ose qira për shfrytëzimin e maqinave të tratave.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Të gjitha Shpenzimet për mbajtjen dhe shfrytëzimin e maqinave të ndërtimit ndahen :

a) Shpenzime të njëhershme.

b) Shpenzime të vazhdueshme

Shpenzime të njëhershme janë të gjitha shpenzimet e permendura në germen «a» në fillim të këtij artikulli ; të gjitha shpenzimet e tjera të përmendura në germat e tjera këtu sipër bejnë pjesë në shpenzimet e vazhdueshme.

Shpenzimet efektive për mbajtjen dhe shtrydëzimin e maqinave të ndërtimit, shpërndaden periodikisht n'objektet e ndryshem, me proporcion me kohën e punës të bëra nga këto maqineri në seicilin objekt ndërttimi.

Art. 6

N'elementin e katert të shpenzimeve direkte përfshihen :

a) Shpenzimet për transportimin të brendëshëm të kantierit d.m.th. shpenzimet për transportimin e materialeve prej magazinës së objektit deri vendin e venijes së tyre në vepër. Këto shpenzime kur bëhen rë punë krahu) (karro dorë etj.) preventivohen në zërin meditja kryesore, ndersa kur bëhen me mje'e tranportimi të mekanizuara ose primitive preventivohen në këtë ze d m.th. në transportin e brendëshëm. Transporti i brendëshëm dallohet nga transporti i jashtëm mbasi, ndersa transporti i brendëshëm nuk hyn në koston e materialit -por preventohet në zë të veçantë, transporti i jashtëm hyn në koston e materialit i cili, siç thamë n'artikullin 3 vtë keti instruksioni, llogaritet franko depo magazin e objektit. Pra shpenzimet për sjelljen e materialeve prej depos pranë objektit deri në vendin e venies së tyre në punë nuk përfshihen në koston e materialeve, por shkojnë, siç thamë, me koston e transportit (elementi i 4-të i strukturës) kur sillen me mjete transporti ose në koston e meditjeve kryesore (elementi i II-të i strukturës) kur sillen me punë krahu.

b) Shpenzimet për furnizimin me energji, gaz, avull, ujë etj. qofshin këto të prodhuara nga vetë ndermarrja ose të furnizuara nga ente të tjera, per gjithmonë vetëm ajo pjesë që i takon ndërtimit kryesor si p,sh. ndriçimi i vendit të punës, kur punohet naten, ujët që nevoitet për përzjerjen e materialeve të tjera. Theksojmë se nuk shkojnë në këte ze dhe nuk preventivohen këtu shpenzimet e keti lloji që bëhen për maqinerinë e ndertimit, për repartet e prodhimit, për administratën e kantierit ndërtimit e tjera.

Gjithashtu në këte ze parashikohen edhe : 1) Shpenzimet për marjon me qera të lokaleve për strehim kantieri për rastet kur llogaritet më e leverdisme që në vend të ngrihet kantier të shfrytëzohen për këtë qëllim ndërtesë ekzistuese, 2) Shpenzimet për furnizim me ujë me mjete transporti etj. për rastet kur nuk ka leverdi ose mundësi të përfshihet në ngritjen e kantierit ndertimi i ujësjellësave dhe 3 Shpenzime tjera të këti lloji.

Art. 7

II) SHPENZIME PLOTSUESE

Shpenzimet plotsuese janë shpenzimet që i referohen gjithë ndërtimit dhe që shpërndahen periodikisht n'objektet e veçantë, në një mënyrë të përcaktuar.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Shpenzimet plotsuese llogariten në dy mënyra :

1) Në punimet e ndertimit, me përqindje mbi shumën totale të shpenzimeve direkte d m.th. mbi shumën e elementave 1 deri 4 (inklusi V-të strukturës së kostos.

2) Në montimin e pajisjes (maqineri dhe aparature). me perqindje mbi pagen bazë të punëtorëve t'okupuar me montimin e pajisjeve.

Në këto përqindje përfshihet edhe fitimi i planifikuar në masen 3%.

Art. 8

Kuotat e shpenzimeve plotësonjëse, t'aprovuara në nenin 6 t'urdhëresës veçanerisht për çdo lloj punimesh, aplikohen si vijon :

1) Kuota prej 10% aplikohet në punimet për montimin e konstruksioneve metalike të çfardo lloji Si montime të tillë kuptojmë montimin e pjesëve që i jepen të gatshëm ndertimit si p.sh. ngritja e oxhaqeve metalike në Cerrik, montimi i estekades në H/Çentralin ENVER etj.

2) Kuota prek 14% aplikohet në punimet e montimit të konstruksioneve metalike t'urave hekurudhore dhe rrugëve automobilistike, të cilat i jepen të gateshme ndërtimit si p.sh. montimi i urave Beiley dhe t'atyre Herbert. Nuk konsiderohen punime montimi në një urë metalike, të gjitha punimet e tjera si p sh. hapja e themeleve, betonimi i bezamenteve e i kembëve t'urës me gjithë punimet e tjera anekse që ndihmojnë në montimin e urës. (Skeleri të ndryshme prej druri dhe instalime të ndryshme që mund të nerojiten), Këto të fundit janë punime të zakonëshme ndertimi dhe hyjnë kuoten prej 18%.

Gjithashtu montimet e ureve metalike dallohen nga ndërtimet e urave metalike, të cilat pregatiten dhe montohen në vend nga vetë Ndjet e Ndertimit. Si urë të tilla kemi ate të Skurejt në rrugën e Dritës, uren e Vau-Spasit, ate të Rrogozhinës etj. Këto ura janë pregatitur me copra hekuri që disponoheshin dhe pastaj janë montuar, prandaj kanë karakterin e punimeve të ndërtimeve metalike dhe hyjnë në kuoten prej 18%.

3) Kuota prej 35% aplikohet në gjithë punimet nëntokës për npërtimin galerive dhe tunelevo. Të gjithë punimet tjera jasht këtyre d.m.th mbi tokë do të konsideronhen simbas rastit punime ndertimi me kuote 18% ose punime bonifikimi me kuote 14%.

4) Kuota prej 24% aplikohet në punimet e bonifikimeve dhe të ndërtimit të kanaleve vaditëse, Punime të tilla do të konsiderohen të gjithë punimet për tharje e vaditje duke përfshirë : levizjet e dheut për hapjen e kanaleve dhe ndërtimin e veprave t'artit si p.sh. mure mbajtes, priza, kaskada, tombino. (misione, prita-diga. urë-kanale e tjera. Nuk përfshihen në punime bonifikimi shpenzimet për ngritje kantieri, të cilat janë punime ndërtimi dhe hyjnë në kuotën prej 18%.

5) Kuote prej 18% aplikohet në të gjitha punimet e tjera të ndërtimit, si në banesë, në godina të ndryshme p.sh shkolla, institute, çerdhe, në ndërtime, në ndërtime industriale, në ngritjen e kantierit të gjitha llojeve të ndryshme të punimeve, në ndërtimin e rrugëve bashkë me veprat e artit të tyre si ura, ombino, murembajtëse e tjera, në ndërtimin e urave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe ureve, në ndërtimin ujësjellësave, në ndërtimin e vajgueresjellësave, në ndërtimet metalike si të çentraleve termo elektrike ose në ndërtimin ee rezervuareve metalike e tjera, duke përjashtuar mon-

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

timin e pjesëve metalike që i jepen ndërtimit të gatëshme dhe që hyjnë simbas rastit në kuotat 10% ose 14% të siper-permendura.

6) Kuota prej 100% aplikohet në montimin e pajisjeve (maqineri dhe aparatura) si p.sh. për vijat e transmisioneve dhe elektronenstacioneve lineare për paisjen elektro teknike të korentit me tension t'ulet dhe të ndriçimit industrial, për pojisjen e transportit vertikal, për pajisjen kimike dhe pajisjen e teleferikëve, pajisjen termo-mekanike të farkëtarëve, të presave, të makinave të vogla të kazaneve për paisjen metalugjike etj.

Mbi kuoton prej 100°/₀ të sipërme bëhen këto shtesa: a) në masën 5°/₀ mbi pagën bazë të punëtorëve t'okucuar në montimin e pajisjes, për të përballuar pagesën e materialeve të vogla ndihmëse që përdoren direkt për montimin e pajisjeve : b) në masën 3,5°/₀ mbi koston e materialeve që shfrytëzohen për montimin e pajisjeve për të përballuar shpenzimet e aparatit të furnizimit dhe të depozitimit dhe për firot e zakonëshme të këtyre materialeve.

Art. 9

Shpenzimet plotësuese ndahen në dy grupe :
a) shpenzimet administrative ekonomike
b) shpenzime të tjera plotësuese.

Art. 10

Shpenzimet administrative ekonomike përbëhen nga shpenzimet e mbajtjes së aparatit të ndërtimit që udhëheq punët e ndërtimit dhe montimit.

Shpenzimet ekonomike administrative ndahen në këto zera :

a) Rrogat bazë dhe suplementare dhe shtesat e punonjësve inxhinero-teknik, të nëpunësave dhe të personelit shërbyes.

b) Shpenzime të veçanta transporti.

c) Shpenzime misioni.

ç) Shpenzime transformimi.

d) Shpenzime zyre, postelegrafonike dhe shtypshkrime.

dh) Shpenzime të tjera administrative ekonomike (mirëmbajtja dhe amortizimi i ndërtesave dhe pajimeve dhe shpenzime të tjera të ndryshme)

Art. 11

Shpenzimet e tjera plotësuese ndahen n'evidencën e kontabilitetit në kapitujt e poshtë-shenuara :

I. MEDITJA PLOTËSUESE DHE SHTESA.

Në këtë kapitull përfshihen : a) pengesa e punëtorëve për kohën e ndërprerjes së punës nga shkaku i konditave atmosferike, b) mos dalje ose ndërprerja e punës në lidhje me plotësimin e detyravë shtetnore dhe shoqërore, c) lejet e zakonëshme dhe ditët e festave që u paguhen punëtorëve në bazë të dispozitave në fuqi, ç) shtesat që u paguhen brigadierëve për drejtimin në punë të brigadës, d) kontributet për sigurimin shoqëror të punëtorëve.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Pagesat për ndërprerje të punës në bazë të ligjeve në fuqi (ndërprerja e punës së nënave q'u japin gji fëmijëve etj.) nuk kontabilizohen në meditjet plotësonjëse, por në meditje kryesore.

II. MBROJTJA E PUNËS,

Në këtë kapitull përfshihen :

a) Sendet neutralizonjëse si qumësht, yndyrna etj. dhe ato të pastrimit në punë si sapun etj. që në bazë të dispozitave në fuqi duhet t'u vihen në dispozicion gratis punonjësve.

b) Blerja e leteraturës. pllakave dhe mjeteve të tjera propogandimi mbi masët për mbrojtjen teknike në punë.

c) Shpenzimet për dhënien e ndihmës mjeksore në zonat e ndërtimit si rrogat e personelit sanitar, mirëmbajtja dhe dizenfektimi i lokaleve, shpenzimet për medikamente etj. Këto shpenzime rëndojnë mbi ndërmarrjen vetëm për pjesën që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, nuk përballohet nga buxheti i shtetit.

ç) Shpenzimet për konsumimin (prishjen) pastrimin dhe riparimin e rrobeve speciale të punës, për rastet e parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

III. SHPENZIMET E EKONOMISË BANESAVE.

Në këtë kapitull përfshihen humbjet e ekonomisë banesave të ndërmarrjeve të ndertimit që rrjedhin nga diferenca midis kostos të shërbimeve t'ekonomisë të banesave dhe asajë pjese të tyre që mbulohet nga vetë punonjësit. simbas dispozitave ligjore në fuqi.

Në koston e ekonomisë të banesave hyjnë : qira e banesës ose kuota e amortizimit të saje, ngrohje, ndriçimi. mbajtja e pastërtisë të lokaleve, meremetimi i zakonëshëm dhe amortizimi i inventarit të banesave dhe i çdo gjëje të nevojëshme për strehimin e punonjësve.

IV. GRUMBULLIMI I ORGANIZUAR I PUNTORISË.

Në këtë kapitull përfshihen :

a) Shpenzimet për grumbullimin e organizuar të forcave punonjëse duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit të puntorëve dhe çdo shpërblim tjetër që ju takon, në bazë të dispozitave ligjore, në fuqi.

b) Shpenzimet për spostimin transferimin e punonjësve nga një vend pune në një tjetër.

c) Shpenzimet për mbajtjen e aparatit për grumbuliimin e organizuar të puntorëve.

V. KONSUMI (AMORTIZIMI) I NGREHINAVE TË VOGLA PROVIZORE.

Në këtë kapitull përfshihet: Amortizimi i ngrehinave të vogla provizore të cilat nuk përfshihen në pjesën e tretë të preventivit të përgjithëshëm (ngritje kantjeri) si p. sh. benkot e punimeve, gropat e gelqeres, dushet, ngrehinat e vogla provizore me vlefte njesore maksimale lek 10.000 (dhjetmijë) si dhe adaptimet dhe sistemimet që nevojiten për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e punës. Kuotat e amortizimit për gjithë ngrehimet dhe

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

adaptimet provizore të nait-permendura bëhet periodikisht duke marë parasysh afatin e shërbimit të tyre në ndërtim dhe kur afati i shërbimit të tyre e kalon afatin e ndërtimit, duke u mbështetur në kohë zgjatjen e ndërtimit, Shuma e konsumit (amortizimit) përcaktohet duke u mbështetur në koston fillestare të këtyrë ngrehinove provizore, duke zbritur vleftën e materialeve që do të rakuperohen mbas smontimit të tyre.

VI. KONSUMI (AMORTIZIMI) I INVENTARIT DHE VEGLAVE ME ÇMIM TË VOGËL DHE QË KONSUMOHEN SHPEJT (INVENTARI I IMËT).

Në këtë kapitull përfshihen shpenzimet për konsumimin (amortizimin) e inventarit dhe veglave me çmim të vogël dhe që konsumohen shpejt (inventar i imët).

VII. SHPENZIME UDHËTIMI E DIETE.

Këtu përfshihen shpenzimet e udhëtimit e dietet të personelit administrativ që meret me grumbullimin e organizuar të punëtorisë.

VIII. SHPENZIME PER ÇPIKJE, PERFEKSIONIME TEKNIKE E RACIONALIZIME.

Këtu përfshihen shpenzimet për provat e materialeve e konstruksioneve dhe shpenzime tjera që bëhen për çpikje, përfeksionime teknike e racionalizime.

IX. SHPENZIME TË NDRYSHME PLOTËSUESE.

Në këtë kapitull përfshihen:

a) Amortizimi, mirëmbajtja dhe riparimi i zakonshëm i inventarit dhe i instalimeve zjarfikse, pagesa e rrogave të personelit zjarrfikës dhe të rojes kantierit dhe shpenzimet e tjera të tyre simbas dispozitave ligjore në fuqi.

b) Shpenzimet për kontrollimin e kualitetit të materialeve e konstruksioneve si p. sh. eksportimet e tjera.

c) Sistemimi i mirë (zbukurimi) i zonës rreth kantierit, si dhe shpenzimet për zbukurime që bëhen me rastin e parakalimit të punonjësve në festat nacionale,

ç) Mirëmbajtja e mekanizmave të vagla të ndërtimit që nuk janë përfshirë në çmimet njesore të preventivit, dhe prandaj nuk bëjë pjesë të shpenzimeve direkte, si : arganellat kave çeliku, krikot traponet, korakullat e tjera, vendosja e tyre në zonën e ndërtimit dhe shpenzimet për anergji dhe material ndihmës, që kanë lidhje me punimin e këtyre veglave dhe mekanizmave.

d) Shpenzimet për dorezimin e punimeve, pastrimi i lokalevet, laria e dyshemevet, xhameve e tjera.

dh) Interesat mbi paradhëniet dhe kreditë bankare, gjobët, kamat vonesat e tjera.

e) Punime të vogla ndërtimi të pa parashikuara në preventiv

ë) Dietet që përfitojnë punëtorët në sektorin e ndërtimit simbas dispozitave ligjore në fuqi.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Art. 12

Shpenzimet plotësuese ndahen periodikisht (çdo muaj ose tremujor) n'ekonomitë përkatëse dhe n'objektet e ndërtimit dhe montimit në propor cion me mëditjet kryesore të punëtorëve prodhonjës.

Në ngarkim të shpenzimeve të shfrytëzimit të maqinerisë të ndërtimi nuk kalohen shpenzime plotësuese, por shpenzimet plotësuese të tyre kontabilizohen në llogarin e përbashkët të shpenzimeve plotësuese të ndërtimit kryesor.

Art 13

Prodhimet dhe shërbimet e reparteve ndihmëse që kanë bilaç indipendent i ngarkohen ndërtimit kryesor në bazë të çmimeve të preventivimit shpenzimet direkte dhe shpenzimet suplementare për njësi predhimi) minus detyrën e uljes kostos që mund t'i veië në fillim të vitit (mbas eprovimit të planeve financiare) Ministrija reparteve të Nd/jeve me bilanc indipendent.

Prodhimet dhe Shërbimet e reporteve ndihmëse, që nuk kanë bilanç indipendent, i ngarkohen ndërtimit kryesor në baze të kostos efektive.

Art. 14.

Në koston e punimeve të ndërtimit duhet me doemos të kontabilizohet amortizimi i të gjitha mjeteve kryesore (maqinat e ndërtimit, mjetet e transportit, ndërtimet e përkohëshme dhe të tjera).

Amortizimi i këtyre mjeteve kryesore llogaritet çdo muaj ose tremujor dhe hyn në përbërjen e elementave të veçanta të shpenzimeve direkte ose të shpenzimeve plotësuese, simbas ka akterit të mjeteve kryesore.

Amortizimi nuk llogaritet për mjetet kryesore që hiqen nga prodhimi dhe vihen në ruajtje me autorizimin e Këshillit të Ministrave për Ndërmarrjet Nacionale dhe me autorizimin e Komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qarkut ose rrethit përkatës për ndë marrjet lokale.

Gjithashtu nuk llogaritet amortizim për mjetet kryesore që ndodhen asht përdorimit, në rast se nxjerrja e tyre jasht përdorimit, është justifikuar me proçes verbol të rregullt

Llogaritet amortizim për kohën që mjetet kryesore kalojnë në riparimin e tyre ose në ndërprerje të punës.

Art .15

Amortizimi i ndërtesave, ndërtimeve dhe instalimeve të përkohëshme që përfshihen në preventiv, që parashikohet se do të smontohet mbas përfundimit të ndërtimit bëhet duke u nisur prej afatit të supozuar të shërbimit të tyre.

Shuma e amortizimit caktohet duke marë parasysh vleftën materialeeve që do të rekuperohen nga smontimi ose t'ardhurat nga shitja e ndërtesave dhe ndërtimeve të nalt-përmendura.

Ndërtesat, ndërtimet dhe instalimet e përkohëshme të përfshira në preventiv, që mbas përfundimit të ndërtimit, i dorëzohen ndërmarrjes veproñjëse, amortizohen simbas rregullave të caktuara për llojin përkatës të mjeteve kryesore.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Ndërtesat, ndërtimet e instalimet e përkohëshme (ngritje kantieri) në preventiv llogariten me vlerën e plotë të materialit dhe në ndërtimet në sipermarrje, në fund të preventivit, zbritet vlefta e materialit që parashikohet se do të rekuperohet nga demontimi i tyre në përfundim të punimeve Mbas përfundimit t'objektit. është në fakultet të punëdhënësit të kërkojë dorëzimin e tyre pa ndonjë shpërblim ose demontimin e tyre dhe tërheqjen e materialit nga ana e sipërmarësit, duke zbritur me këtë rast nga situacioni i fundit shumën e parashëkuar në preventiv si rikuperim materiali.

Art. 16

Nuk lejohet të lihet ndonjë shpenzim plotësonjës pa u përfshirë në llogari të ndërtimit, me përjashtim të qiranave të parapaguara. shpenzimet për organizmin në stil të gjërë të grumbullimit të forcave punojëse dhe të tjera shpenzime që bëhen për llogari të periudhave t'ardhëshme, këto shpenzime i përkasin pjesërisht ose totalisht viteve të ardhëshme dhe konabilizohen përkohesisht në llogarinë «Shpenzime të parapaguara»

Art. 17

Ky instruksion hyn në fuqi me 1 Janar 1956. Të gjitha interpretimet e bërë para kësaj date konsiderohen të mi.ëqena.

MINISTRI I FINANCAVE:
ABDYL KËLLEZI

MINISTRI I NDERTIMIT
JOSIF PASHKO

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0

NDRIM EMËRI

Me vendim të Ministris P. Brëndëshme Nr. 7 dt 20 II-196 ndroi emërin Berije Vasku në Enverije Vasku.

Me vendim të Ministris P. Brendëshme Nr. 35 dt. 17-VIII- 1955 ndroi emrin Igli Durra në Ilir Durra.

Me vendim të Ministris P. Brendëshme Nr. 12 dt 8-VI-1955 ndroi mbiemrin familjarisht Sinan Brahimaj në Zotaj.

Me vendim të Ministris P. Brendëshme Nr. 6 dt. 31-I-1956 ndroi emrin Life Kurt Miçaj në Myzejen Kurt Miçaj.

Me vendim të Ministris P. Brëndëshme Nr. 11 dt. 20-IV- 1596 ndroi emrin Xhemile Doçellari në Sanije Doçellerit.

Approved For Release 2007/12/12 : CIA-RDP83-00418R006900400001-0